



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i **Biologjisë** në *Fakultetin e Shkencave të Natyrës* në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për nevojat e tij , për mbulimin e procesit mësimor, për vitin akademik 2025-2026, semestri i II-të shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme, kategoria profesor.

Kriteret e përgjithshme e të veçanta për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme** të kategorisë profesor, për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të jetë i kategorisë profesor;
2. Fusha e studimit dhe kërkimit shkencor të jetë në Biostatikë;
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie;
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së (preferohet gjuha angleze) të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi;
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
7. Të jetë i aftë për punë;
8. Leje nga punëdhënësi për ushtrimin e mësimdhënies në UE.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **05.02.2026** deri **14.02.2026** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti).
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen **intervistës** në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare** për periudhën **05.02.2026** deri **14.02.2026**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Rruga “Ismail Zyma”
Aplikim në Fakultetin i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Biologjisë
Elbasan**